



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

VENDIM I NDËRMJETËM

Nr.2494, datë 14.08.2014

Për

“Miratimin e shtyrjes së afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Individual miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP Nr.530 datë 26.12.2008 të Operatorit të Telefonisë së Lëvizshme GSM në Republikën e Shqipërisë - Albanian Mobile Communications sh.a. “.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- | | | |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 4. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare Znj. Anilda Mulgeci, në mbledhjen e datës 14.08. 2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e shtyrjes së afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Individual miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP Nr.530 datë 26.12.2008 të Operatorit të Telefonisë së Lëvizshme GSM në Republikën e Shqipërisë - Albanian Mobile Communications sh.a. “.

BAZA LIGJORE:

1. VKM Nr.496 datë 22.07.2014, për “Miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim”.
2. Ligji Nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative”.
3. Ligji nr.9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, (*ligji nr. 9918*).

4. Urdhëri nr.1168 datë 14.05.2014, i ndryshuar, për “Ngritjen e grupit të punës për të vlerësuar përmbushjen e kushteve të përdorimit të frekuencave GSM900 dhe GSM1800 nga Sipërmarrësi Albanian Mobile Communications sh.a.”

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

- 1- Relacioni përkatës sebashku me materialet shkresore shoqeruese;
 - 2- Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar;
- Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N s e:

1. AKEP, mbështetur në nenin 71 dhe 73 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" (ligji nr. 9918), i ndryshuar, nëpërmjet shkresës nr.1327 datë 19.05.2014, filloi veprimet paraprake për të vlerësuar përmbushjen e kushteve të përdorimit të frekuencave të brezit GSM të përcaktuara në Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr.530 datë 26.12.2008 nga Sipërmarrësi Albanian Mobile Communications sh.a.
2. Sipërmarrësi Albanian Mobile Communications sh.a. depoziton në AKEP shkresën nr.1406 Prot, datë 23.05.2014, “Kërkesë për zgjatjen e vlefshmërisë së Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave”.
3. Sipërmarrësi Albanian Mobile Communications sh.a. në përgjigje të shkresës së AKEP si dhe parashtrimeve ligjore për këtë çështje, me shkresën nr.1327/1 datë 06.06.2014 përcjell në AKEP informacionin përkatës.
4. Neni 73 i ligjit nr.9918. datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, parashikon që në rastin e autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim, rregullat dhe procedurat e rinovimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

Në konformitet dhe në zbatim të VKM Nr.496 datë 22.07.2014, për “Miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim”, AKEP i drejtoi AMC shkresën me nr. nr.1819 datë 25.07.2014 (vetëm një ditë pas miratimit të Vendimit), ku i kërkohej informacion shtesë dhe

mendim për çmimin e përdorimit të frekuencave të brezit GSM dhe AMC brenda afateve të përcaktuara në këtë VKM kthen përgjigje me shkresën nr.2694/3 datë 01.08.2014.

Duke qenë se:

- afati i **vlefshmërisë së** Autorizimit Individual miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP Nr.530 datë 26.12.2008 të Operatorit të Telefonisë së Lëvizshme GSM në Republikën e Shqipërisë - Albanian Mobile Communications sh.a. përfundon **me datë 19.08.2014 si dhe**
- **afatet procedurale të përcaktuar në VKM Nr.496** datë 22.07.2014 deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga AKEP në përfundim të procesit për dhënien e Autorizimit Individual të rinovuar,

nuk është e mundur të përmbushen për shkak të rrethanave konkrete të faktit që VKM Nr.496 u publikua me datë 25.07.2014, sa me sipër grupi i punës vlerëson se AKEP nuk arrin që të marrë një vendim përfundimtar për rinovimin e Autorizimit Individual të Sipërmarrësit Albanian Mobile Communications sh.a. në kushtet e përmbushjes së detyrimit të VKM.

Në këto kushte grupi i punës bazuar në VKM Nr.496 datë 22.07.2014, për "Miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrin" Kreu IV, Te tjera, paragrafi 2) propozon **marrjen e një vendimi të ndërmjetëm, për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Individual deri në marrjen e vendimit përfundimtar.**

Grupi i punës i ngritur me Urdhërin nr.1168 datë 14.05.2014, i ndryshuar, për "Ngritjen e grupit të punës për të vlerësuar përmbushjen e kushteve të përdorimit të frekuencave GSM900 dhe GSM1800 nga Sipërmarrësi Albanian Mobile Communications sh.a." ka përgatitur dokumentacionin për "Miratimin e vendimit të ndërmjetëm, për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Individual miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP Nr.530 datë 26.12.2008 të Operatorit të Telefonisë së Lëvizshme GSM në Republikën e Shqipërisë - Albanian Mobile Communications sh.a. ". është në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë:

- Bazën ligjore të sipërcituar, materialet e përgatitura nga grupi i punës për marrjen e këtij Vendimi të ndërmjetëm mbi shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Individual të Operatorit të Telefonisë së Lëvizshme GSM në Republikën e Shqipërisë - Albanian Mobile Communications sh.a. ",

V E N D O S:

1. Të miratojë shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Individual miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP Nr.530 datë 26.12.2008 të Operatorit të Telefonisë së Lëvizshme GSM në Republikën e Shqipërisë - Albanian Mobile Communications sh.a. deri në marrjen e vendimit përfundimtar.
2. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. Alban KARAPICI _____
2. Alketa MUKAVELATI _____
3. Benon PALOKA _____
4. Zamira NURÇE _____